



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:176849
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05491822

P.nr.194/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe bashkëpunëtoren profesionale Hajrije Krasniqi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit F.d K., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, ndërsa sipas aktakuzës PP/II.nr.914/23 të dt. 06.12.2023, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, të dt.21.03.2024, ku prezent ishin Prokurori i shtetit Venera Shala, i akuzuari F. K., me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av. Nuhi Krasniqi, me dt. 22.03.2024, shpallë dhe e përpilon këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: F. K., nga i ati K. dhe e ëma Xh. e lindjes F., i lindur më datën, në fshatin L., Komuna e Malishevës, ku edhe jeton, me nr. personal, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i martuar, i ati i 3 (tre) fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, punëtor privat, i gjendjes së dobët ekonomike, shfrytëzues i ndihmave sociale.

Ë S H T Ë F A J T O R

I. për shkak se nga data e pacaktuar e deri me datën 22.06.2023 në shtëpinë e tij në fshatin Ll., Komuna Malishevë, i pandehuri F. K. ka mbajtur në pronësi armë në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit për Armë Nr. 05/L-022, dhe atë një pistoletë me gaz të tipit E. J. D., me nr. serik ... me kalibër 9mm së bashku me një karikator dhe dy fishek të njëjtit kalibër, në atë mënyrë që pasi zyrtarët policorë kishin siguruar informacione se i pandehuri posedon armë dhe atë përmes një video-incizimi ku shihej i pandehuri me një armë, ditën kritike pas një pune operative nga ana e policisë është identifikuar i pandehuri si dhe i është sekuestruar arma nga ana e zyrtarëve policorë.

- me këto veprime ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

II. Gjatë muajit qershor të vitit 2023, në shtëpinë e tij në fshatin Ll., Komuna Malishevë, i pandehuri F. K. në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët

(Ligji Nr.05/L-022) dhe pa pasur të drejtë ka përdorur armën të cilën e kishte pa leje dhe atë pistoletën me gaz të tipit Ekol Jackol Dual, me nr. serik EJC-... me kalibër 9mm, në atë mënyrë që i pandehuri shtënë disa herë në ajër në një aheng familjar, ndërsa ky veprim i tij është vërejtur pas disa kohe kur i pandehuri e ka publikuar këtë video incizim në rrjetin social F..

- me këto veprime ka kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 17, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69,76 par. 1 dhe 2 pika 2.3 dhe nenit 366 par.1 dhe nenit 367 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovë, të njëjtin e:

G J Y K O N

I. Për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, të përshkruar si në dispozitivin II-të, të aktakuzës i shqipton: **Dënim me burgim** në kohëzgjatje prej **tetë (8) muaj**, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

II. Për veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, të përshkruar si në dispozitivin e I-rë të aktakuzës, i shqipton: **Dënimin me burgim** në kohëzgjatje prej **një (1) viti**, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Gjykata, konform nenit 76 par. 1 dhe 2 pika 2.3 të KPRK-së, të akuzuarit për veprat penale, i shqipton këtë:

DËNIM UNIK ME KUSHT

Duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **pesëmbëdhjetë (15) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej **dy (2) viteve** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

URDHËROHET Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gj. që ta mbikëqyrë dhe ta ekzekutojë dënimin me burgim me kusht, ashtu që **OBLIGOHET** i akuzuari që të mbajë kontaktin me Shërbimin Sprovues të Kosovës në Gj..

Konform nenit 366 par.3 dhe nenit 367 par.3 të KPRK-së, të akuzuarit i shqiptohet dënimi plotësues ashtu që i konfiskohet arma – pistoletë me gaz e tipit Ekol Jackol Dual, me nr. serik EJC-..., me kalibër 9mm, së bashku me një karikator dhe dy fishek me kalibër 9mm, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, kjo armë duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, me bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Gjakovë, pasi që të vërtetohet se kjo armë nuk është përdorur në ndonjë krim tjetër.

I akuzuari F. K., lirohet nga obligimi në pagesën e paushallit gjyqësor dhe kompensimin e viktimave të krimit dhe te njëjtat bien barrë e mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr. 914/23 të dt. 06.12.2023, e ka akuzuar F. K., për shkak të veprave penale Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar si dhe administrimit të provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 21.03.2024, ku prezent ishin Prokurori i shtetit Venera Shala, i akuzuari F. K. me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av. Nuhi Krasniqi, andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari F. K., pas konsultimit me mbrojtësin e tij av. Nuhi Krasniqi, në shqyrtimin fillestar është deklaruar i fajshëm për veprat penale për të cilat ngarkohet, duke shtuar se më vjen keq për rastin i cili ka ndodhur, për të cilin jam penduar.

Mbrojtësi i të akuzuarit F. K., av. Nuhi Krasniqi në shqyrtimin fillestar ka deklaruar: pas bisedës me të mbrojturin tim dhe sqarimeve të nevojshme i njëjti në mënyrë vullnetare i pranon veprat penale për të cilat ngarkohet, andaj kërkoj nga gjykata që të aprovohet pranimi i fajësisë dhe me rastin e shqyrtimit të dënimit të merr parasysh të dhënë se ai veprat i ka pranuar që nga fillimi i procedurës ndaj tij. Po ashtu nga gjykata kërkoj që si rrethana lehtësuese gjatë shqyrtimit të dënimit të merr parasysh të dhënë se ai nuk ka vepra tjera të kryera, se është mbajtës i familjes dhe ka tre (3) fëmijë të mitur, po ashtu i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike dhe është shfrytëzues i ndihmave sociale të cilën gjë e dëshmon edhe me kartelën e ndihmave sociale të lëshuar nga QPS në M..

Prokurori i Shtetit Venera Shala në shqyrtimin fillestar ka deklaruar: duke pasur parasysh se i akuzuari e pranoj fajësinë si në dispozitiv të aktakuzës paraprakisht duke i parë pasojat dhe pas konsultimit me mbrojtësin e tij, e po ashtu ky pranim fajësie mbështetet në faktet e çështjes andaj kërkojmë nga gjykata të pranojë si të tillë si shprehje e vullnetit të tillë. Propozojmë gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ti shqiptoj një dënim të paraparë me ligj duke pasur parasysh shkallen e përgjegjësisë dhe

rrezikshmërisë së veprave penale. E gjithashtu sa i përket rrethanave të ketë parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë sh ai akuzuari, pendimin e tij, ndërsa rrethanat rënduese i lëmë në vlerësim të gjykatës, po ashtu sipas pikës III të aktakuzës në kuptim të nenit 366 par.3 të KPRK-së, propozoj që të konfiskohet një pistoletë me gaz e tipit Ekol Jackol Dual, me nr. serik EJC-... me kalibër 9mm, së bashku me një karikator dhe dy fishek të të njëjtit kalibër.

2. Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPRK-së. Gjatë pranimin të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u cekën me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-Se i akuzuari F. K. ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë;

- Raporti fillestar i incidentit me nr. të rastit ... i datës 22.06.2023;
- Raporti i oficeri P. Z. i datës 22.06.2023;
- Deklarata e të pandehurit F.K. dhënë në polici me datë 22.06.2023 dhe në prokurori me datën 01.12.2023;
- Raporti i Njësisë së Forenzikës, i datës 22.06.2023 023;
- Lista e armeve të sekuestruara e datës 22.06.2023;
- Procesverbali mbi kontrollin e shtëpisë i datës 22.06.2023;
- Fotografitë si dhe shkresat tjera në lëndë.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 366, par.1 të KPRK-së është përcaktuar: „ Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet”. Ndërsa, në nenin 367, par.1 të KPRK-së është përcaktuar: „ Kushdo që përdorë armë apo

materie plasëse në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse të tilla, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet”,

5. Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin F. K., e ka shpallur fajtor për veprat penale për të cilat ngarkohet, nga se në veprimet e tij të përshkruara si në pikën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprave penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprave penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ashtu që gjykata me rastin e caktimit të dënimit pati parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajit nga ana e të pandehurit, i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tija, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, është i ati i tre (3) fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me asistencë sociale, për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata mori parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, dhe për këtë gjykata të pandehurit i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjithnjë duke konsideruar se me dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarit mund të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Konfiskimi i armës

Konform nenit 366 par.3 dhe nenit 367 par.3 të KPRK-së, të akuzuarit i shqiptohet dënimi plotësues ashtu që i konfiskohet arma - pistoletë me gaz e tipit Ekol Jackol Dual, me nr. serik EJC-..., me kalibër 9mm, së bashku me një karikator dhe dy fishek me kalibër 9mm.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi mbi lirimin e të akuzuarit nga shpenzimet e procedurës është marr konform nenit 452 par.4 të KPPK- së për faktin se gjykata konsideron se me pagimin e shpenzimeve do të rrezikohej gjendja materiale e të akuzuarit, pasi që është përfitues i

ndihmës sociale, ku i njëjti gjykatës ia ka dorëzuar një kopje të librezës nr. ... e dt. 01.03.2023, që vërteton sei akuzuari F. K. është përfitues i ndihmës sociale.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.194/23 dt.22.03.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale
Hajrije Krasniqi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Lulzim Paçarizi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.